

Programi për integrimin e trashëgimisë kulturore

Vendi: Rajonale

Numri i Projektit: 49640

Sektori i biznesit: Prona dhe Turizëm

Mënyra e njoftimit: Private

Kategoria mjedisore: IESE

Data e synuar për Bord: 27 Shkurt 2018

Statusi: Aprovuar nga Bordi

Data e publikimit të dokumentit përmbledhës: 26 Janar 2018

Përshkrimi i Projektit

Krijimi i një Platforme të Trashëgimisë Kulturore (Programi) me vlerë 150 miliardë euro për të mbështetur projekte që stimulojnë zhvillimin ekonomik përmes përdorimit të burimeve të disponueshme të trashëgimisë kulturore.

Programi do të përfshijë hua dhe financime të kapitalit për sektorin privat, si edhe hua për qeveritë, bashkitë dhe kompanitë shtetërore për projekte në Uzbekistan, Rumani, Shqipëri, Jordani dhe Bregun Perëndimor (Vendet Pilot).

Trashëgimia kulturore është një burim i rëndësishëm për zhvillimin rajonal dhe të komunitetit në shumë vende ku BERZH operon, por mbetet një burim i pashfrytëzuar për shkak të një sfidave të ndryshme si (mungesa e fondeve, mungesa e ekspertizës, mungesa e aksesit dhe ndërlidhjeve, mungesa e koordinimit dhe komunikimit midis grupeve të shumta të interesit, etj). BERZH mund të ofrojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar për të mbështetur zhvillimin kulturor, i cili vepron si një katalizator për zhvillimin ekonomik dhe punësimin, si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

Në kuadër të programit, BERZH do të mbështetet në ekspertizën e saj për financimin e një plani madhor që do të synojë rigjallërimin, restaurimin e ndërtesave historike, dhe përmirësimin e infrastrukturës. Programi gjithashtu do të përftojë nga mundësitë për bashkëpunim midis sektorëve, si atij privat ashtu edhe atij publik, dhe do të angazhohet në ndërmjetësimin e dialogut midis palëve të ndryshme të interesit (qeverisë, donatorëve, konsulentëve) për të arritur një qasjegjithëpërfshirëse.

Objektivat e Projektit

Qëllimi i programit është të shërbejë si një katalizator ndërsektorial për zhvillimin rajonal duke vënë në përdorim burimet e trashëgimisë kulturore në Vendet Pilote, për të stimuluar turizmin dhe zhvillimin ekonomik. Kjo do të arrihet përmes investimeve si dhe angazhimit institucional dhe politik për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të masave në nivel vendor për menaxhimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore dhe komercializimin, si edhe për zhvillimin e nismave dhe modeleve të turizmit të qëndrueshëm. Përmes planeve të masave, programi do të promovojë sektorin privat dhe përfshirjen e komunitetit.

Impakti në tranzicion

Platforma do të ndikojë në dy cilësitë kryesore të impaktit të tranzicionit: (1) Në Konkureshmëri: Konkureshmëria në turizëm; dhe (2) "Mirëqeverisje": nëpërmjet qeverisjes së përmirësuar dhe menaxhimit të qendrave të trashëgimisë kulturore, dhe komercializimit të tyre. Investimet nën këtë platformë do të mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë konkureshmërinë individuale të kompanive vendase, infrastrukturës dhe rretheve, psh. nëpërmjet zgjerimit të kapaciteteve, rindërtimit ose ristrukturimit. Kjo pritet të risë konkureshmërinë në tërësi dhe tërheqjen e turizmit në rajonet e synuara. Për më tepër, secili program vendor do të përfshijë një komponent për angazhimin me politikën me autoritetet përkatëse dhe grupet vendase të interesit. Veprimtaritë për politikën do të synojnë identifikimin e sfidave kryesore, do të koordinojnë aktivitetet mes palëve të interesit, dhe të ofrojnë udhëzime strategjike për të promovuar zhvillimin e turizmit përreth qendrave të trashëgimisë kulturore. Në rastet e zgjedhura, cilësi të tjera të tranzicionit mund të prezantohen në nivel vendor, në përputhje me prioritetet e strategjike të vendit dhe nevojat specifike të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe turizmin.

Informacioni për klientin

Huamarrësit potencialë nën këtë program do të jenë kompani private, qeveritë, bashkitë dhe kompanitë shtetërore. Për huatë me garanci sovraane shlyerja e huave do të jetë kompetencë e Ministrisë së Financave, bashkive ose kompanive të shërbimit të cilat mund të hyjnë në marrëdhënie me palë të treta.

Shuma e financimit të BERZH

€ 150,000,000.00

Kostoja totale e projektit

€ 150,000,000.00

Përmbledhja sociale dhe mjedisore

Programi në vetvete nuk kategorizohet nën Politikën Sociale dhe Mjedisore të vitit 2014 të Bankës, por, çdo nën-projekt do të kategorizohet sipas rastit dhe do jetë subjekt i vlerësimit individual mjedisor dhe social specifik për projektin dhe klientin. Bazuar në riskun e nën-projektit dhe kategorinë, Vlerësimi i duhur Social dhe Mjedisor do të verifikojë nëse secili nën-projekt është i strukturuar përputhje me Kriteret e Performancës të Bankës.

Vlerësimi Social dhe Mjedisor do të fokusohet në çështje specifike mjedisore dhe sociale, si edhe në zbatimin e masave të nevojshme parandaluese. Çështje të mundshme mjedisore dhe sociale mund të përfshijnë: përputhshmërinë ligjore, këshillimin publik, sigurimin e jetës dhe ndaj zjarrit, çështjet ekologjike të qendrave të nën-projektit, shpronësimet dhe zhvendosjen e banorëve, punën dhe Shëndetin dhe Sigurinë në punë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, si edhe përdorimit të saj për përfitime sociale dhe ekonomike nga komuniteti. Kjo do të vlerësohet përmes angazhimit të grupeve respektive të interesit. Disa nën-projekte mund të kërkojnë inputin e konsulentëve për të bërë vlerësimin mjedisor dhe social dhe angazhimin e grupeve të interesit.

Bashkëpunimi teknik

Suksesi i Programit dhe nënshkrimi i nën-projekteve nën këtë platformë është në varësi të granteve që do të tërheqë BERZH në mbështetje të:

(i) vlerësimit fillestar që duhet ndërmarrë, për të ndihmuar në zhvillimin e planeve të masave në bashkëpunim me grupet respektive të interesit

(ii) prokurimit të shërbimeve të këshillimit, ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimit (psh. Për SVMM, zejtarët, për të lehtësuar transferimin e aftësive, duke përfshirë zhvillimin strategjik të biznesit) që do të ofrohet nga partnerë dhe konsulentë;

(iii) angazhimit të komunitetit; dhe

(iv) vlerësimit selektiv dhe monitorimit.

Nevojat për bashkëpunim teknik dhe buxhetet do të përcaktohen në bazë të vlerësimit të nevojave të secilit nën-projekt.

Përsa i përket transaksioneve të infrastrukturës, do të nevojiteshin grante të bashkëpunimit teknik dhe grante që nuk lidhen me bashkëpunimin teknik përpara dhe pas nënshkrimit për të ndihmuar me përgatitjen e studimit teknik të fizibilitetit, prokurimin e të mirave dhe shërbimeve, zhvillimin e dokumentave të tenderit, vlerësimin e tenderit, kontraktimin, si edhe monitorimin dhe aktivitete të tjera.

Informacioni për Kontaktet e Kompanive

Mundësitë e Biznesit

Për mundësi biznesi ose prokurime, kontaktoni kompaninë kliente.

Informacione të përgjithshme

Informacione rreth projektit të BERZH-it që nuk lidhen me prokurimin:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e bën publik informacionin dhe këshillohet me palët e veta të interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe perceptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të tij. Ju lutemi vizitoni faqen e mëposhtme të Politikës së Informimit Publik për të zbuluar se si të kërkonit Raportin e Bordit të Sektorit Publik.

[Teksti i PIP](#)

Mekanizmi i Ankimit të Projektit (MAP)

[Mekanizmi i Ankimit të Projektit \(MAP\)](#) është mekanizmi i llogaridhënies së BERZH-it. Ai mundëson shqyrtimin e pavarur të ankesave të individëve dhe organizatave lidhur me projektet e financuara nga BERZH-i, të cilat mendohet të kenë shkaktuar, apo të kenë gjasa të shkaktojnë dëme mjedisore dhe sociale.

Ju lutemi vizitoni faqen e [Mekanizmit të Ankimit të Projektit](#) për më tepër informacion rreth mënyrës së depozitimit të një ankese. Përgjegjësi i MAP-it (pcm@ebrd.com) është në dispozicionin tuaj për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje që mund të keni lidhur me depozitimin e një ankese dhe kriteret për regjistrimin dhe përputhshmërinë, në pajtim me [Rregullat e Procedurës së MAP-it](#).